



Datë: 18.05.2026

A.nr.1993/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1993/2025, të datës 08.12.2025, të parashtruar nga ankuesit A.L dhe A.S, nga Prishtina, kundër organit të punësimit Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike ‘*kompensim material*’, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 1, paragrafi 3, dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.05.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1993/2025, e datës 08.12.2025, e parashtruar nga ankuesit, A.L dhe A.S.

II Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. Ref.396/2025, i datës 16.09.2025, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

A r s y e t i m

Ankuesit A.L dhe A.S (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesit), më datë 08.12.2025, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. Ref.396/2025, të datës 16.09.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për shkak të shkeljes së Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, Ligjit Nr. 03/L-212 për Punën, Ligjit Nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publikë dhe shkeljes së Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa, kjo e fundit, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me provat ndërlidhur me çështjen në procedurë të shqyrtimit dhe vendosjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova këto prova: Ankesën me numër protokolli 7743/2025 të datës 08.12.2025 të parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Pagesën për muajin tetor për ankuesin A.L; Kopjen e ID-së së ankuesit A.L; Kërkesën për pagesë shtesë për angazhim jashtë orarit e datës 01.08.2025 nga ankuesit; Vendimin me Nr. Ref.396/2025, të datës 16.09.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Pagesën për periudhën tetor 2025 për ankuesin A.S; Kopjen e ID-së ankuesit A.S; Plotësimin e ankesës nga ankuesit datës 09.12.2025; Opinionin ligjor nga Departamenti Ligjit i MPJD; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.12.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 17.12.2025; Vendimin e datës 15.04.2010 për emërimin e ankuesit A.S si Sekretar i parë në Shkup; Raportin e prezencës në punës për ankuesin A.S dhe A.L për muajin shtator-dhjetor 2025; Akt emërimin e datës 01.08.2024 të ankuesit A.S dhe A.L; Raportin e punës jashtë orarit të punës, Kujdestarisë dhe gatishmërisë 24/7 datë 02.10.2025; Emailin e datës 02.12.2025 nga V.N për I.M dhe H.B; Emailin e datës 24.11.2025 nga A.L për V.B; Emailin e datës 04.11.2025 nga V.B për ankuesit; Emailin e datës 03.11.2025 nga ankuesi A.L për H.B; Emailin e datës 03.11.2025 nga H.B për ankuesin A.L; Emailin e datës 03.11.2025 nga ankuesi A.L për H.B; Emailin e datës 17.09.2025 nga V.B për ankuesin A.L; Emailin e datës 17.09.2025 nga ankuesi A.L për H.B dhe V.B; Emailin e datës 16.09.2025 nga Xh.S për ankuesit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesve, *sepse*:

Çështja e fakteve

Nga administrimi i provave të lëndës, rezulton:

- Ankuesit janë të punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ashtu që, ankuesi A. L sipas Akt Emërimit me Nr. 921/2024, të datës 01.08.2024, ushtron pozitën Udhëheqës i Qendrës për Menaxhimin e Krizave, ndërsa, ankuesi A.S, sipas Akt Emërimit me Nr. 922/2024, të datës 01.08.2024, është i punësuar në pozitën Zyrtar i Lartë për Emergjencë, të dy në kuadër të Qendrës për Menaxhimin e Krizave.
- Ankuesit më datë 01.08.2025, kanë parashtruar kërkesë me numër reference 09/2025, tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me të cilin kanë kërkuar kompensimin për angazhimin jashtë orarit të punës.
- Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 16.09.2025, ka nxjerr Vendimin Nr. Ref. 396/2025 me të cilin ka aprovuar kërkesën e ankueseve, duke llogaritur shumën financiare të kompensimit prej 20% të pagës bazë, duke detyruar ankuesit që të mbajnë evidencë të rregullt të punës jashtë orarit.

Pretendimet ankimore

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshtojnë Vendimin Nr.Ref.396/2025, të datës 16.09.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, duke pretenduar pretendojnë se akti i kundërshtuar me ankesë është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, Ligjit Nr. 03/L-212 për Punën, Ligjit Nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publikë, pasi që nuk është njohur e drejta në mënyrë retroaktive nga momenti i emërimit në këto pozita. Kërkojnë shfuqizimin e vendimit dhe marrjen e vendimit nga Këshilli për kompensimin në mënyrë retroaktive për angazhim jashtë orarit nga momenti i emërimit në këto pozita.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit për trajtim të drejtë dhe meritore të çështjen ankimore, iu referua:

I. Ligjit Nr.08/L-197 për Zyratet Publikë:

-Neni 6 paragrafi 1, 2 dhe 3 : *1. Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues dhe sprovues të Kosovës; 1.2. anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm; 2. Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. trajnimet dhe zhvillimin profesional; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve; 2.6. përcaktimin e shkeljeve dhe masave disiplinore shtesë; 2.7. disiplinën dhe vlerësimin. 3. Ne rast të rregullimit me ligj të veçantë, për shërbyesin civil me status të veçantë - dispozita mbizotëruese janë dispozitat e ligjit të veçantë.*

-Neni 22: *Për orët e punës së kryer, zyrtarja/i publik ka të drejtën e pagës. Paga e zyrtares/it publik rregullohet me Ligjin përkatës për Pagat në Sektorin Publik.*

II. Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik:

- Neni 1 [Qëllimi]: *1. Qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhoheshim ku elementi kryesor është paga bazë.*

- Neni 13 [Paga e nëpunëses/it civil] : *“Paga e nëpunëses/it civile përbëhet nga paga bazë, shtesat dhe kompensimet, kur shtesat dhe kompensimet janë të aplikueshme sipas këtij ligji”.*

-Neni 35 paragrafi 1: *“1. Kompensimet që mund të përfitohen në bazë të këtij ligji janë: 1.1. kompensimi për kujdestari; 1.2. kompensimi për punë gjatë natës dhe jashtë orarit të punës; 1.3. kompensimi për punë gjatë fundjavës dhe ditëve të festave zyrtare; 1.4. kompensimi për udhëtime dhe shpenzimet e përfaqësimit; 1.5. kompensimi për funksionin shtesë; 1.6. kompensimi për anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm; dhe 1.7. kompensimi për stafin tjetër të administratës që punojnë jashtë vendit”.*

III. Rregullores (QRK) Nr. 07/2023 për Kompensimin për Kujdestari, Punën Gjatë Natës dhe Punën Jashtë Orarit të Punës:

-Neni 4 paragrafi 1, 2 dhe 3: *1. Zyrtarët publik dhe kategoritë e tjera të të punësuarve që paguhen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, përfitojnë kompensim në vlerë monetare apo me pushim për punën në kujdestari, punën gjatë natës dhe jashtë orarit të punës, punën në fundjavë dhe punën në ditët e festave zyrtare. 2. Kompensimi bëhet për rastet si në vijim: 2.1. për kujdestari – në vlerë prej njëzet për qind (20%) në orë; 2.2. punën gjatë natës – në vlerë prej tridhjetë për qind (30%) në orë; 2.3. punën jashtë orarit të rregullt të punës – në vlerë prej tridhjetë për qind (30%) në orë; 2.4. punën gjatë ditëve të festave zyrtare – në vlerë prej pesëdhjetë për qind (50%) në orë; dhe 2.5. punën gjatë fundjavës – në vlerë prej pesëdhjetë për qind (50%) në orë. 3. Përveç nëse nuk përcaktohet ndryshe me legjislacionin në fuqi, vlera totale e kompensimit për punën shtesë nga orari i rregullt, nuk mund të jetë më e lartë se 1% e fondeve totale të përdorura nga organizata buxhetore në kategorinë e shpenzimeve “Paga dhe Shtesa” të atij viti fiskal.*

- Neni 7: *1. Zyrtarët publik dhe kategoritë e tjera të të punësuarve që paguhen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, kanë të drejtë të kompensohen për punën jashtë orarit të rregullt të punës, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës. 2. Puna jashtë orarit, festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës mund të realizohet vetëm kur i punësuar ka pëlqim nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe ka autorizim paraprak të arsyetuar nga udhëheqësi më i lartë i institucionit. 3. Kompensimi për punën jashtë orarit të rregullt të punës, punën gjatë festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës bëhet me pagesë ose me ditë pushimi. 4. Kompensimi për punën jashtë orarit të rregullt të punës, punën gjatë festave zyrtare dhe ditëve të fundjavës, llogaritet për çdo orë pune, duke i shtuar edhe vlerën si vijon: 4.1. Tridhjetë për qind (30%) në orë për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës; 4.2. Pesëdhjetë për qind (50%) në orë për punën gjatë fundjavës; 4.3. Pesëdhjetë për qind (50%) në orë për punën jashtë orarit gjatë festave zyrtare. 5. I punësuar mund të kërkojë nga institucioni që në vend të kompensimit në vlerë monetare sipas paragrafit 4 të këtij neni, kompensimi t'i bëhet me ditë pushimi. 6. Në pajtim me ligjin përkatës për punë, institucioni mund të vendosë që puna jashtë orarit të rregullt të kompensohet me ditë pushimi. 7. Kompensimi për punë gjatë fundjavës, festave dhe ditëve të lira e përjashtojnë njëratjetrën.*

Duke qenë se ankuesit pretendojnë se me vendimin e kundërshtuar me ankesë janë shkelur dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik dhe Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, Kolegji i Këshillit vë në dukje faktin se Ligji Nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik nuk është i aplikueshëm sepse është shpallur i pavlefshëm nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës sipas Aktgjykimit për rastin KO219/19 të datës 13.07.2020(i njëjti nuk ka qenë i zbatueshëm asnjëherë), po ashtu, dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për Shtesat për të Punësuarit në Sektorin Publik, nuk janë të aplikueshme në këtë rast, ngase më këtë rregullore janë rregulluara shtesa të tjera si: shtesa e performancës, shtesa e kushteve specifike të punës, shtesa për vëllimin e punës dhe shtesa për punën pa orar të paracaktuar.

Andaj, duke u bazuar në kuadrin ligjor si më lartë, Kolegji vlerëson se Sekretari i Përgjithshëm i MMPJD-së ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë ligjin material lidhur me kërkesën e ankuesve të datës 01.08.2025, mbi arsyetimin se ankuesit përmes kësaj shkresë kanë kërkuar njohjen e së drejtës së kompensimit për punë jashtë orarit dhe jo për kompensim retroaktive, ashtu që, edhe më vendimin e kontestuar gjegjësisht me Vendimin Nr. Ref.396/2025, të datës 16.09.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, është njohur

e drejta e ankueseve për kompensim të shtesës për punë jashtë orarit dhe si pasojë e drejtë në kompensim rrjedhë nga data e nxjerrjes së këtij vendimi. Për me tepër, nga shkresat e lëndës të dërguar nga ankuesit por edhe nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nuk evidentohet ndonjë raport i përgatitur nga ankuesit lidhur me angazhimin jashtë orarit para periudhës së njohjes së drejtës së kompensimit.

Andaj, Kolegji i Këshillit bazuar dhe konstatimet si më sipër erdhi në përfundimin se Vendimi Nr. Ref.396/2025, i datës 16.09.2025, i Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së është nxjerr në pajtim të plotë me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 07/2023 për Kompensimin për Kujdestari, Punën Gjatë Natës dhe Punën Jashtë Orarit të Punës, kështu që pretendimet ankimore të ankuesve janë të pabazuar dhe nuk gjejnë mbështetje ligjore.

Thënë si më lartë, e duke u bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.1993/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesve A .L dhe A. S;
- MPJD: Sekretarit të Përgjithshëm dhe Njësisë së Personelit
- Arkivit të KPMSHCK-së;